



Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural

LAJMËRIM PARAPRAK

Për publikim të Thirrjes publike 01/2021 për parashtrim të kërkesës për shfrytëzim të mjeteve nga komponenti i pestë i Instrumentit për ndihmë parahyrëse për zhvillim rural të Bashkimit Evropian (IPARD Programi 2014-2020)

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural i lajmërojnë të gjithë personat e interesuar juridik dhe fizik se në pjesën e parë të muajit qershor 2021 do të shpallet Thirrja publike për dorëzimin e kërkesave për shfrytëzimin e mjeteve financiare nga komponenti i pestë i Instrumentit për ndihmë parahyrëse për zhvillim rural të Bashkimit Evropian (IPARD Programi për periudhën 2014-2020).

Qëllimi i IPARD Programit 2014-2020 është përmes masave përkatëse për përkrahje të bujqësisë dhe zhvillimit rural të përmirësohet konkurrenca e prodhimit bujqësor dhe sektorit bujqësor-ushqimor, përmes harmonizimit të tyre me standardet e Bashkimit Evropian dhe arritjes së ambientit të qëndrueshëm jetësor dhe zhvillim socio-ekonomik në mjediset rurale përmes nxitjes së aktivitetit ekonomik dhe rritjes së mundësive për punësim.

Mjetet financiare nga IPARD Programi 2014-2020 në lidhje me realizimin e kësaj Thirrje publike nga qershori i vitit 2021 dedikohen për masat në vijim:

- Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve, me kufizim të vetëm sektorëve prioritarë në vijim nga masa:
 1. Prodhimtaria bujqësore alternative
 2. Prodhimtaria e prodhimeve ushqimore dhe pijeve edhe atë për llojet e investimeve në vijim:
 - Prodhimet alkoolike nga rrushi ose pemët dhe birra;
 - Ëmbëlsira, brumëra dhe prodhime të pjekjeve;
 - Çaj dhe ekstrakte bimore;
 - Mëlmesa dhe barishte;
 - Peshq të ujërave të ëmbla, gaforre dhe butakë dhe
 - Prodhime të tjera që nuk janë theksuar në Listën e prodhimeve nga Aneksi I i Marrëveshjes për funksionim të BE.
 3. Prodhimtaria e prodhimeve jo-ushqimore
 4. Veprimtari të zejtarisë që janë në pajtim me Rregulloren për përcaktimin e veprimtarive që mund t'i kryejnë zejtarët
 5. Sigurim të shërbimeve në bujqësi
 6. Zhvillim të shërbimeve për banorët e vendeve rurale
 7. Promovim të turizmit rural

Rregullat për shfrytëzimin e mjeteve financiare nga IPARD Programi 2014-2020 udhëzojnë arritjen e kontratës paraprake të shfrytëzuesve potencial me Agjencinë për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural dhe realizimin e investimit të lejuar në pajtim me kushtet e kontraktuar paraprakisht. Kontrollim në vend të ngjarjes dhe zbatimin e mbikëqyrjes së kontratës e kryejnë personat e autorizuar nga Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural dhe institucionet relevante të Republikës së Maqedonisë së Veriut për udhëheqje, zbatim dhe kontroll të IPARD dhe Unioni Evropian.

Mënyra dhe procedura për shfrytëzimin e përkrahjes financiare nga IPARD Programi 2014-2020 janë të shënuara në Rregulloren për mënyrën dhe procedurën për shfrytëzimin e përkrahjes financiare për masat për zhvillim rural të financuara nga komponenti i pestë i Instrumentit për ndihmë parahyrëse për zhvillim rural të Bashkimit Evropian.

Shpallja do të zgjasë **45 ditë** nga dita e shpalljes së Thirrjes publike në shtypin ditor.

VËREJTJE: Dokumentacioni i duhur për përgatitje dhe dorëzim të kërkesave, duke përfshirë dhe Udhëzimet për shfrytëzuesit e mjeteve nga IPARD Programi 2014-2020 do të azhurnohen dhe publikohen në ueb faqen e Agjencisë në periudhën deri në shpalljen e Thirrjes publike.

Informata më detale në lidhje llojet e investimeve, kriteret për fitimin e përkrahjes financiare, lartësia e përkrahjes sipas masave të interesuarit mund t'i marrin në Agjencinë për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural.

Telefoni: 02 3097-460
Faksi: 02 3097-454
e-mail adresa: ipardpa.info@ipardpa.gov.mk
www.pa.gov.mk

Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomizimit të ujërave Sektori për udhëheqje me IPARD
Telefoni: 02 3134-477 лок: 113, 114 и 115
e-mail adresa: info@ipard.gov.mk
www.ipard.gov.mk

Agjencia për nxitje të zhvillimit në bujqësi
Telefoni: 047 228-330
Faksi: 047 228-370
www.agencija.gov.mk çdo ditë pune prej ora 8:30 deri në ora 16:30.

Informata për përgatitjen dhe dorëzim të kërkesave, si dhe këshillat praktike për aplikim, prodhues të interesuarit bujqësorë falas mund t'i marrin në qendrat regjionale të Agjencisë për nxitje të zhvillimit në bujqësi. (Lista e kontakteve të qendrave regjionale dhe personave kompetentë është e shpallur në ueb faqen e institucioneve kompetente)



Instrumenti për ndihmë parahyrëse për zhvillim rural të
Bashkimit Evropian 2014-2020

